

VENDIM
Nr. 32, datë 22.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i“	“	
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“	“	
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i“	“	
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i“	“	
Admir Thanza	Anëtar i“	“	

me sekretare Edmira Babaj, në datë 20.03.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 4 Akti, që i përket:

KËRKUES : Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë, e përfaqësuar nga Gentian Marku, me autorizim.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Zef Nikolli

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-(585), datë 13.04.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 27, 28 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuarit Gentian Marku, i cili kërkoj pranimin e kërkesës, subjektin e interesuar Zef Nikolli, i cili kërkoj rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Mbështetur në aktet bashkëngjitur kërkesës rezulton se Zef Nikolli (subjekti i interesuar) është larguar nga detyra që ai ushtronte pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë (kërkuar) me vendim të kësaj të fundit.

Subjekti i interesuar kundërshtoi këtë vendim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër. Kjo e fundit, me vendimin nr. 428 (374 të regjistrimit themelor), datë 15.07.2009, vendosi pranimin pjesërisht të padisë së subjektit të interesuar.

Kundër këtij vendimi kërkuar ushtroi të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë e cila, me vendimin nr 00-2011-(585), datë 13.04.2011 (vendimi objekt i kërkesës) vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga ana e kërkuarit me pretendimin se rekursi “është paraqitur në datën 03.01.2010” pra jashtë afatit që përcakton ligji.

Kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), duke pretenduar se vendimi objekt kërkesë duhet të shpallet në kundërshtim me kushtetutën dhe të shfuqizohet për arsye se është marrë si rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Këtë pretendim kërkuar e mbështet në arsyetimin se vendimi objekt kërkesë ka cenuar të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar rekursin me arsyetimin e gabuar se ai ishte

paraqitur jashtë afatit.

Subjekti i interesuar, ka pretenduar me shkrim dhe në seancë plenare se pretendimi i kërkuarit nuk përputhet me realitetin, pasi në dijeni të tij rekursi është depozituar jashtë afatit.

II

1. Mbi legjitimitimin e kërkuarit

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se duhet të ndalet paraprakisht në çështjen e legjitimitimit të kërkuarit.

Gjykata vëren se kërkuari nuk është një person fizik “individ” në kuptimin e nenit 131/f të Kushtetutës por një person juridik publik. Gjykata Kushtetuese ka një qëndrim të konsoliduar tashtëm mbi kriteret që personat juridik duhet të përmbushin që të legjitimohen për të paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesë për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se një person juridik “*legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse ky legjitimim nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik (publik apo privat), por nga natyra e pretendimeve që ai parashtron. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është person juridik publik që ka pretenduar shkeljen e të drejtave procedurale që rrjedhin nga Kushtetuta. Në këtë drejtim, duhet bërë dallimi midis legjitimitimit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. Shteti ose organet përbërëse të tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfitues të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.*” (shih vendimin nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në rastin në shqyrtim kërkuari pretendon cenimin e një të drejte themelore procedurale. Më konkretisht, vërehet se kërkuari është person juridik publik, i paditur në gjykimin në themel, dhe pretendon cenimin e parimeve procedurale kushtetuese të ankimimit dhe të aksesit në gjykatë.

Gjykata vlerëson se këto parime nuk mund të cenohen, sepse janë elemente të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt, duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë (shih vendimin nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).

Rrjedhimisht, në vijim të qëndrimit të saj pasqyruar si më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuari legjitimohet për të paraqitur kërkesën përpara saj pasi pretendon cenimin e një të drejte themelore procedurale.

2. Mbi pretendimin për cenimin e të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit)

Kërkuari parashtron se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mohimit të së drejtës së aksesit, pasi edhe pse ai kishte depozituar rekursin brenda afatit ligjor tridhjetë ditë për dorëzimin e tij, Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar atë me arsyetimin se ishte paraqitur tej këtij afati.

Gjykata Kushtetuese vëren se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se “*Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet e GJK nr.14 datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.03.2008). Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar*

gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses (Shih vendimet e GJK nr. 5 datë 06.03.2009 dhe nr. 17, datë 19.06.2009). E drejta e aksesit në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (vendimi i GJK nr 18, datë 08.07.2009).

Kërkuesi parashtron se Gjykata e Lartë, me vendimin objekt kërkesë, ka cenuar thelbin e të drejtës për akses në gjykatë pasi nuk ka shqyrtuar pretendimet e tij të paraqitura në rekurs. Sipas tij, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është haptazi i gabuar pasi ai ka depozituar rekursin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë më datë 03.08.2009 dhe jo më datë 03.01.2010 siç arsyeton Gjykata e Lartë në vendimin objekt kërkesë. Faktin që rekursi është depozituar më datë 03.08.2009 kërkuesi e provon me vulën (që mban datën 03.08.2009) dhe nënshkrimin e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë që figurojnë në kopjen e rekursit që ai disponon si dhe me fotokopjen e regjistrit të ankimeve që i është komunikuar kërkuesit nga kjo gjykatë, në të cilin rekursi figuron me numrin rendor 28 dhe datën 03.08.2009.

Gjykata Kushtetuese, mbështetur mbi aktet dhe elementet e paraqitura nga kërkuesi, dosjen gjyqësore dhe shkresën me nr. 112 prot., datë 26.03.2012 të Kancelarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstaton se rekursi i kërkuesit figuron me numrin rendor 28 dhe është depozituar në datën 03.08.2009.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese mbështetur në aktet e sipër përmendura vlerëson se rezultoi e provuar se rekursi është ushtruar nga kërkuesi në datën 03.08.2009, pra brenda afatit ligjor tridhjetë ditor. Rrjedhimisht, Gjykata e Lartë, duke mos e shqyrtuar rekursin me arsyetimin se ai është paraqitur tej këtij afati, ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesit në një mënyrë që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2011-(585), datë 13.04.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi);
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.